

URDHËR
Nr. 238, datë 7.3.2025

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË AFTËS EPIZOOTIKE TË SHFAQUR NË SHTETIN E HUNGARISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, në nenin 43 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe të tranzitimit për në territorin e Republikës së Shqipërisë:
 - a) gjithë kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra;
 - b) materialit biologjik dhe të pashoqëruara me test diagnostik PCR të rezultuar negativ i bashkëlidhur certifikata shëndetësore veterinare, të kryer 21 ditë para mbledhjes së tyre;
 - c) mishin e freskët;
 - ç) produktet e mishit të patrajuara me të paktën me një temperaturë prej 70°C për 30 minuta;
 - d) qumështin dhe produktet e qumështit të patrajuara termikisht me një temperaturë minimale prej 72°C për 15 sekonda (temperaturë e lartë – kohë e shkurtër pasterizimi (HTST) e aplikuar 2 herë) ose çdo trajtim tjetër ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - dh) leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të papërpunuara të patrajuara ose papërpunuara ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike;
 - e) ushqim me përmbajtje proteinike dhe ushqimi i kafshëve ruminantë dhe derra të patrajuara termikisht ku nuk vërtetohet shkatërrimi i virusit të aftës epizootike.
- Sipas njoftimeve të marra nga faqja zyrtare e ADIS-ës dhe WAHIS, përkatësisht nga ndarjet administrative të tabelës së mëposhtme të shtetit të Hungarisë:

<i>Ndarja administrative e nivelit të parë</i>	<i>Ndarja administrative e nivelit të dytë</i>	<i>Ndarja administrative e nivelit të tretë</i>
Győr-Moson-Sopron*	Győr*	

Shënim: Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht, brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra, materialit biologjik, embrioneve, mishin e freskët, produktet dhe nënprodukteve të tyre, qumështin, produktet e qumështit, mielli i mishit, mielli i gjakut, leshit, qimeve, lëkurëve dhe lëkurëve të trajtuara dhe të papërpunuara dhe ushqimit të kafshëve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe derra.
3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj